



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri i dosjes:** KSC-CC-PR-2020-09

**Vendosi:** **Kryetarja e Dhomave të Specializuara**  
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

**Administratore:** Dr. Fidelma Donlon

**Data:** 11 maj 2020

**Titulli i dosjes:** Kërkesë për ndryshimin e vendit të zhvillimit të procedurës në shtetin pritës për Dhomën e Specializuar të Gjykatës Kushtetuese

---

**Publik**

---

**Vendim mbi kërkesën për ndryshimin e vendit të procedurës para Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese lidhur me referimet në pajtim me nenin 19(5) të Ligjit**

---

**Autoriteti kërkues:**

Kryetari i panelit të Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese

**KRYETARJA** e Dhomave të Specializuara ( “Kryetarja”), pasi ka marrë kërkesën e kryetarit të panelit të Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese ( “DHSGJK”) për caktimin e vendit të zhvillimit të procedurës në shtetin pritës, me këtë vendim dhe në bazë të nenit 3(8)(d) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ( “Ligji”) vendos për vendin e zhvillimit të procedurës para DHSGJK-së lidhur me ndryshimet e Rregullores së Procedurës dhe të Provave ( “Rregullorja”) në pajtim me nenin 19(5) të Ligjit.

1. Më 29 dhe 30 prill 2020, gjykatësit e Dhomave të Specializuara të Kosovës, me përjashtim të gjykatësve të DHSGJK-së, miratuan në mbledhjen e tyre plenare ( “Plenarja”) ndryshime të 30 rregullave të Rregullores së Procedurës dhe të Provave.
2. Më 1 maj 2020, Kryetarja, në pajtim me nenin 19(5) të Ligjit, ia referoi ndryshimet e 30 rregullave DHSGJK-së.<sup>1</sup>
3. Në të njëjtën ditë, në pajtim me nenin 33(3) të Ligjit, Kryetarja caktoi panelin e Gjykatës Kushtetuese për shqyrtimin e 30 rregullave të ndryshuara, për të garantuar përputhshmërinë e tyre me Kapitullin II të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.<sup>2</sup>
4. Më 7 maj 2020, kryetari i panelit të DHSGJK-së kërkoi caktimin e vendit të zhvillimit të procedurës në shtetin pritës në pajtim me nenin 3(8)(c) të Ligjit.<sup>3</sup>
5. Në lidhje me këtë kërkesë zbatohen dispozitat ligjore sikurse është përcaktuar më herët.<sup>4</sup>

---

<sup>1</sup> KSC-CC-PR-2020-09, F00001, Referim i ndryshimeve të Rregullores së Procedurës dhe të Provave drejtuar Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, publik me shtojcë konfidenciale, 1 maj 2020.

<sup>2</sup> KSC-CC-PR-2020-09/F00002, Vendim për caktimin e panelit të Gjykatës Kushtetuese të Dhomave të Specializuara, Kryetarja, 1 maj 2020.

<sup>3</sup> KSC-CC-PR-2020-09/F00003, Kërkesë për ndryshimin e vendit të zhvillimit të procedurës në lidhje me referimin e ndryshimeve të Rregullores së Procedurës dhe të Provave, DHSGJK, 7 maj 2020.

<sup>4</sup> Krahaso me: KSC-CC-PR-2017-02, Vendim mbi vendin e zhvillimit të procedurave para Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese për shqyrtimin e Rregullores së Procedurës dhe të Provave në pajtim me nenin 19(5) të Ligjit, Kryetarja, 12 prill 2017, para. 6-9; KSC-CC-2019-05/KSC-CC-2019-06, Vendim për vendin e zhvillimit të procedurave para Dhomave të Specializuara të Gjykatës Kushtetuese, Kryetarja, 22 janar 2019, para. 6-9.

6. Kryetarja kujton se kërkesa e mëparshme për ndryshimin e vendit të të gjitha procedurave të ardhshme para DHSGJK-së në bazë të 'Vendimit për vendin e zhvillimit të procedurave para Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese' është i zbatueshëm vetëm për të gjitha procedurat e ardhshme që burojnë prej referimeve të parashtruara në bazë të nenit 49 të Ligjit dhe jo për ato në bazë të nenit 19(5) të Ligjit.<sup>5</sup>

**PËR ARSYET E LARTPËRMENDURA DHE NË PAJTIM ME NENIN 3(8)(d) TË LIGJIT,  
KRYETARJA NË VIJIM**

**cakton vendin** e zhvillimit të procedurës para Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese lidhur me shqyrtimin e tanishëm të ndryshimeve të 30 rregullave si edhe të të gjitha referimeve të ardhshme në pajtim me nenin 19(5) të Ligjit në shtetin pritës, që Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese të mblidhet, kuvendojë, të marrë dhe lëshojë parashtrime të protokolluara në selinë e Dhomave të Specializuara në shtetin pritës; dhe **kërkon** prej Administratores që të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për zbatimin e këtij vendimi.

/nënshkrim/

Gjykatëse Ekaterina Trendafilova,  
Kryetare e Dhomave të Specializuara

E hënë, 11 maj 2020

Në Hagë, Holandë

---

<sup>5</sup> KSC-CC-2019-05/KSC-CC-2019-06, Vendim për vendin e zhvillimit të procedurave para Dhomave të Specializuara të Gjykatës Kushtetuese, Kryetarja, 22 janar 2019, para. 10.